



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2018:066294  
Datë: 15.11.2021  
Numri i dokumentit: 02395751

**PA1.nr.983/2021**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti i përgjithshëm, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Zyhdë Haziri, anëtarë, me sekretaren juridike, Fitnete Hoti, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.K., nga fshati ....., komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme në vazhdimësi nga neni 332 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit L.K., av.Bahrije Xhyliqi, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.200/18, të datës 15.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 08.11.2021 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit L.K., av. Bahrije Xhyliqi, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.200/18, të datës 15.06.2021, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.200/18, të datës 15.06.2021, është shpallur fajtor i akuzuari L.K., për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me kusht duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Është detyruar i akuzuari që në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, të liroj ngastrat kadastrale 619, 621, 623, 624, 625 në vendin e quajtur “Stupovi te Komuna” Zona Kadastrale Kijevë, duke e njoftuar se nëse lirimi i pronës nuk bëhet në mënyrë vullnetare, atëherë do të bëhet me dhunë nga organet kompetente.

I dëmtuari B.K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Është obliguar i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato, sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit L.K., av. Bahrije Xhyliqi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, apo që i njëjti të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën PPA/II.nr.1000/2021, të datës 30.07.2021, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka propozuar që ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit L.K., av. Bahrije Xhyliqi, të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, aktgjykimin e ankimuar, shkresat e tjera të lëndës, si dhe propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, ka gjetur se:

#### **Ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit L.K., av. Bahrije Xhyliqi, nuk është e bazuar.**

Sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit L.K., av. Bahrije Xhyliqi, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke theksuar se aktgjykimi i ankimuar është i bazuar në prova të papranueshme. Aktakuza P.nr. 1224/2017 e dt. 21.05.2018, e ngritur nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, nuk bazohet në prova të drejtpërdrejtë, në prova origjinale, në prova materiale dhe prova të plota, por as gjykata e shkallës së parë gjatë marrjes së aktgjykimit nuk është bazuar në prova materiale, prova që luajnë rol vendimtar bazuar në parimin e kërkitimit dhe gjetjes së vërtetës në marrjen e aktgjykimit, që në procedurën penale konsiderohet parim bazik, por bazohet vetëm në deklaratën e palës së dëmtuar dhe po ti bëhet një analizë e thukët aktakuzës dhe provave të cilave gjykata dhe prokuroria ua ka falur besimin, del se ky rast është i natyrës civile, andaj gjykata ka qenë dashur që në fillim ta pushoj procedurën ndaj të akuzuarit. Duke e shpallur fajtor të akuzuarin për sipërfaqet e këtyre pronave, aktgjykimi e ka tejkalluar akuzën, ngase gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari ka në shfrytëzim një sipërfaqe të caktuar të pronës, respektivisht një pjesë të objektit shoqëror të ish NSH “Mirusha”, të cilën e shfrytëzon për banim, në të cilën është vendosur me pëlqimin e stafit të kësaj ndërmarrje që nga viti 2000, dhe në atë pjesë të objektit edhe tani gjendet duke banuar dhe nuk ka të bëjë fare me pronat të cilat i ka pasur në shfrytëzim i dëmtuari dhe deri tani asnjëherë nga NSH “Mirusha” dhe as nga KK Malishevë, nuk i është kërkuar që ta liroj këtë objekt dhe pjesën e tokës që e shfrytëzon si oborr. Dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë dhe kontradiktor, asnjë fakt qenësor në dispozitivin e aktgjykimit nuk është i arsyetuar me provë përkatëse. Të gjitha shkeljet e përmendura kanë ndikuar që gjykata të nxjerrë një aktgjykim të padrejtë dhe të anulueshëm. Gjykata e shkallës së parë nuk e ka arsyetuar me asnjë provë është provuar se i akuzuari në mënyrë të paligjshme dhe në vazhdimësi ka uzurpuar pronat e të dëmtuarit. Edhe pse gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata e shkallës së parë i administroi provat si kontratën e

prokurimit me nr. 03/4605 e dt. 18.12.2008, kopjen e planit të dt. 16.11.2012, historiatin e pronave të lëshuara nga KK – Malishevë, askund nuk përmendet fakti se i dëmtuari i ka pasur në shfrytëzim këto parcela, e po ashtu, edhe pjesën e objektit dhe pronës që është duke e shfrytëzuar i akuzuari që nga viti 2000, kjo pjesë respektivisht objekt, nuk ka qenë objekt i kontratës së nënshkruar në mes të komunës së Malishevës dhe të dëmtuarit. Si duket, gjykata e shkallës së parë është bazuar vetëm në një aktvendim të gjykatës C.nr.172/12, i cili ka të bëjë me pengim posedim, e iniciuar jashtë afatit ligjor nga paditësi këtu i akuzuar, ndërsa provat e paraqitura nga i akuzuari në këtë çështje penale nuk i ka vlerësuar dhe nuk e ka kontestuar fare faktin se që të dy si i akuzuari ashtu edhe i dëmtuari janë shfrytëzues të pronave. Andaj, në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë është dashur që të jetë më e kujdesshme me rastin e zbatimit të ligjit dhe vlerësimit të provave.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit L.K., av. Bahrije Xhyliqi, përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, për të cilat shkelje ky kolegji përkujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 394 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihet me shkeljet e pretenduara nga neni 384 i KPPK, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten si dhe pjesët tjera të aktgjykimit, se në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, janë paraqitur arsyet përkitazi me faktet vendimtare të cilat e karakterizojnë veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit. Se gjykata e shkallës së parë në arsyetim ka paraqitur të gjitha arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, rezulton nga aktgjykimi i ankimuar. Po ashtu, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përmban formën e paraparë me shkrim, në kuptim të nenit 370 të KPPK, pasi që i njëjti përmban të gjitha pjesët që duhet ti përmbaj aktgjykimi, se në arsyetim të aktgjykimit janë paraqitur arsyet përkitazi me çdo pikë të njëjtit, se në arsyetim të aktgjykimit janë paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë dhe të saktë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i ka konsideruar si të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Sa i përket pretendimit të mbrojtëses së të akuzuarit se me aktgjykimin e ankimuar është tejkaluar aktakuza, kolegji i ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe ka ardhur në përfundim se ky pretendim nuk qëndron, për shkak se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në tërësi është gjykuar çështja penale konkrete sikurse në aktakuzën e ngritur nga ana e prokurorisë.

Sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit L.K., av. Bahrije Xhyliqi, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljes së ligjit penal, duke theksuar se me rastin e shpalljes fajtor dhe shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit në mungesë të akuzuarit, nuk mund të formohet vepra penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, përderisa nuk ka vepër penale, nuk mund të ketë as përgjegjësi penale.

Kolegji i kësaj gjykate, ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit L.K., av. Bahrije Xhyliqi, përkitazi me shkeljet e ligjit penal nga neni 385 i KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 394 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet e pretenduara, pasi që vepra e cila i vihet në barrë të akuzuarit, përbën vepër penale të dënueshme sipas dispozitave të KPPK, se nuk kanë ekzistuar rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale të akuzuarit, e po ashtu nuk kanë ekzistuar as rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, gjithashtu, në këtë çështje penale është aplikuar ligji i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, si dhe gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kuadër të kompetencave ligjore kur e ka gjykuar këtë çështje penale.

Sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit L.K., av. Bahrije Xhyliqi, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar edhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se mungesa e provave ka bërë që gjykata të mos mundet në asnjë mënyrë të

vërtetohet as përfaqësues gjendjen faktike. Edhe ato pak prova që janë administruar, gjykata nuk i vërtetoi në mënyrë të plotë dhe të drejtë. Për më tepër, për veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, gjykata e shkallës së parë, është dashur që të vërtetohet edhe faktet tjera që shkojnë qoftë në dëm apo në dobi të akuzuarit vetëm e vetëm për të ardhur deri te ndriçimi i rastit, sepse fajësimi i të akuzuarit për veprën penale e të cilën nuk mund të provohet se e ka kryer, është edhe në shkelje të nenit 7 të KEDNJ.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e ushtruar nga ana e mbrojtëses së të akuzuarit L.K., av. Bahrije Xhyliqi, dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila gjendje vërtetohet nga provat e administruara në shkresat e lëndës, sikurse janë, kontrata e prokurimit me nr. 03/4605 e dt. 18.12.2008, aktvendimi C.nr. 172/12 i Gjykatës Komonale në Malishevë, kopja e planit e dt. 06.11.2012, zona kadastrale Kijevë Komuna e Malishevës, Historiati me nr. të prot. 06/74/2021 i lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë i Kuvendit Komunal në Malishevë. Nga deklaratat e të dëmtuarit, i cili në mënyrë të detajuar ka përshkruar ngjarjen që nga fillimi i marrjes në posedim të parcelës në fjalë, e vërtetuar sipas kontratës së prokurimit nr. 03/4605 të dt. 18.12.2008, në të cilën objekt i kontratës ishte ndërtimi i objektit afarist dhe banesor me koncesion në fshatin ..., KK- Malishevë, në të cilën edhe ka investuar me çka u vërtetua se i akuzuari këtu është fajtor për këtë veprë penale të uzurpimit, pasi që edhe i akuzuari në mënyrë indirekte e ka pranuar se nuk ka qenë pronar me dokumente e as sipas listën poseduese dhe se i njëjti edhe pse nuk ka pasur asnjë dokument mbi këto ngastra, në momentin kur i është kërkuar që ta liroj pronën ai përsëri ka vazhduar qëndrimin në të. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë i ka falur besimin deklaratës së të dëmtuarit, të dhënë në shqyrtim gjyqësor në cilësi të dëshmitarit, pasi që kjo deklaratë është shumë e qartë dhe është në përputhje të plotë me provat materiale përmes të cilave gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale të tij dhe se në deklaratën e të dëmtuarit nuk ka hapësirë për dyshime pasi që i njëjti në mënyrë të hollësishme ka shpjeguar ngjarjen që nga marrja në shfrytëzim të zonës kadastrale të cekur si më lartë. Andaj, duke marrë parasysh të gjitha ato që u thanë më lartë si dhe provat tjera nga shkresat e lëndës, kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ashtu që gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale e cila i vihet në barrë.

Sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit L.K., av. Bahrije Xhyliqi, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar edhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se nga të gjitha ato që u cekën në ankesë mund të vihet në përfundim se gjykata e shkallës së parë me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, ashtu që ndaj të njëjtit duhet marrë aktgjykim lirues.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila është vërtetuar nga provat e administruara në shkresat e lëndës, ashtu që gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 të KPK, dhe rrethana lehtësuese ka vlerësuar se i akuzuari asnjëherë më parë nuk ka qenë i dënuar, se nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale ndaj tij, se është baba i tre fëmijëve, mbajtës i familjes nëntë anëtarëshe, është punëtor teknik në shkollën e mesme në Kijevë, i gjendjes së dobët ekonomike, se ka pasur sjellje korrekte në gjykatë, kurse si rrethana rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës. Nga ankesa e

mbrojtëses së të akuzuarit nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, andaj, në prani të këtyre rrethanave, kolegji është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 lidhur me nenin 400 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.983/2021, të datës 08.11.2021**

**Sekretarja juridike,**  
**Fitnete Hoti**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Zyhdi Haziri**